

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Izer Maksuti / Ylber Sela

**Agjencia e Zbatimit të Gjuhës
Veprimtaria e saj 2019-2023**

1. Hyrje

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një vend i shumë etnive dhe gjuhëve, pas Marrëveshjes së Ohrit, 13 gusht 2001, kemi ndryshime kushtetuese dhe me këtë edhe një rregullim tjetër të statusit të gjuhëve.

Pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga janari i vitit 2019 dhe pas themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve nga marsi 2019, ka përmirësime të statusit të gjuhës shqipe, por ende mbeten vështirësitë në zbatimin e ligjit dhe ka mjaft sfida në përdorimin zyrtar të shqipes.

Në këtë punim do të bëjmë një paraqitje të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, që nga themelimi. Do pasqyrojmë historikun dhe misionin e saj në procesin e zbatimit të gjuhës shqipe në RMV, si gjuhë e dytë zyrtare. Do përmenden disa prej sfidave kryesore në këtë proces të zbatimit të ligjit të gjuhëve, pengesat për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në vend, krahas maqedonishtes.

Qëllimi i këtij punimi është që në mënyrë të përmbledhur të përmenden ngjarjet kryesore që nga themelimi i Agjencisë, si dhe të përshkruhet shkurtimisht procesi i zbatimit të ligjit.

2. Korniza ligjore për përdorimin e gjuhëve – ligjet e gjuhës

Republika e Maqedonisë, prej vitit 1991 shtet i pavarur, nga 2005 vend Kandidat i BE-së, që nga 12 shkurt 2019 njihet si “Republika e Maqedonisë së Veriut”, dhe nga 27 mars 2020 është vend anëtar i NATO-s.

Sipas statistikave zyrtare, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas regjistrimit të vitit 2021, ka rreth 2 milionë banorë, prej tyre janë rreth 55 %

maqedonas, afër 30 % shqiptarë, 4,7 % turq, 1 % romë, 0,81 % boshnjakë, 0,20% vllleh, si dhe etni të tjera (rreth 1 %).¹

Me Marrëveshjen e Ohrit², 13 gusht 2001, pasuan ndryshime kushtetuese, në bazë të parimeve të një vendi shumetnik, sipas nenit 7, amendamenti V dhe nenit 48 me plotësime nga amendamenti VIII, u parapa edhe përdorimi i gjuhëve në vend, gjuhës maqedonase dhe “çdo gjuhë tjerë e cila flitet së paku nga 20 për qind e popullsisë...”.³ Sipas kësaj kemi ndryshime edhe në përdorimin e gjuhëve në arsim dhe pjesërisht në administratë publike, parlament etj.⁴

“Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20 % e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetadministrimit Lokal” u soll në vitin 2008⁵, pas 3 vitesh më 2011⁶ pati ndryshime të pakta të këtij ligji, që zgjeronin mundësinë e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20%.

“Ligji i Përdorimit të Gjuhëve”⁷ u miratua më 14.03.2018, ndërsa hyri në fuqi prej 14 janarit 2019. Ky ligj përmirëson statusin dhe rrit përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në institucionet shtetërore në administratë, në komuna, në gjykata, në spitale etj., por rishtas e kufizon atë përmes 20%-shit të popullsisë.

Për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve 2019, është debatuar gjatë, po ashtu janë hartuar edhe disa punime shkencore. Veçojmë këtu artikullin e profesor Shezai Rrokaj: *LIGJI PËR GJUHËT NË MAQEDONINË E VERIUT DHE GJUHA SHQIPE*, si dhe shkrimin e studiueses të Universitetit të Gracit, Emma Lantschner: *North Macedonian's Language Law of 2018: To Good to be True?* Te studimi i saj trajtohen, ndër të tjera, përdorimi i gjuhës shqipe në nivel qendror, përdorimi i shqipes në procedurat gjyqësore, si dhe vërejtjet e rekomandimet nga Komisioni i Venecias.⁸

¹ <https://www.dw.com/sq/maqedoni-e-veriut-5421-maqedonas-2952-shqiptar%C3%AB-sipas-regjistrimit/a-61304666> (31.01.2023)

² Marrëveshja Kornizë e Ohrit, https://mls.gov.mk/images/laws/Marrevshja_e_Ohrit.pdf /Ohrid Framework Agreement, <https://www.osce.org/skopje/100622> (12.02.2025)

³ <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/Kushtetuta%20e%20RM-se%20Final%20ALB.pdf> (12.01.2025)

⁴ *Gazeta zyrtare* 91/2001.

⁵ *Gazeta zyrtare*, nr. 101, f. 8-14, 13.08.2008.

⁶ *Gazeta zyrtare*, nr. 100, f. 2, 25.07.2011.

⁷ *Gazeta zyrtare*, nr. 7, f. 14-19, 14.01.2019.

⁸ Për më shumë mbi rekomandimet e Komisionit të Venecias për këtë çështje shih:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)033-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)033-e),

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2019\)019-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2019)019-e) (19.09.2022)

Edhe te përmbledhja e punimeve të KONFERENCËS shkencore ndërkombëtare, me temë bosht: “*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*”, mbajtur më 21-22 shkurt 2020, botuar nga Agjencia në vitin 2021, gjejmë një pjesë të mirë të punimeve, që trajtojnë këtë ligj të gjuhëve dhe sfidat e zbatimit të tij.

3. Themelimi i Agjencisë dhe veprimtaria e saj

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, më 14 janar 2019, neni 18 i këtij ligji, parashih themelimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të vendit dhe, si person juridik, kjo do të ketë kompetenca të përdorimit të barabartë të gjuhëve. Po japim të plotë tekstin e nenit 18, që t’ia lehtësojmë lexuesit, njohjen me kompetencat dhe rolin e Agjencisë, për zbatimin e këtij ligji:

(1) Për realizimin e qëllimeve të këtij ligji, për promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e barabartë të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj, themelohet Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) me cilësinë e personit juridik, kompetente për standardizimin dhe përdorimin e barabartë të gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj me trupat ndihmëse për mbështetjen e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucioneve të tjera.

(2) Drejtorin e Agjencisë e zgjedh Qeveria e Republikës së Maqedonisë me thirrje publike të shpallur paraprakisht, me mandat prej 4 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

(3) Në Agjenci, krahas përkthyesve të autorizuar gjyqësorë punësohen edhe linguistë dhe filologë të diplomuar të gjuhës shqipe, si dhe lektorë të licencuar.

(4) Drejtori e përfaqëson Agjencinë, udhëheq me punën e saj, i kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe miraton program vjetor për punën e Agjencisë. Drejtori paraqet raport për punën e Agjencisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë sëpaku një herë në vit deri më 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(5) Mjetet për punën dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Brenda një kohe të shkurtër, nisi procedura e shpalljes së konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë dhe filluan përgatitjet për

konsolidimin e saj. Më datë 25 shkurt 2019, si drejtor i parë i Agjencisë u zgjodh prof. dr. Ylber Sela, i cili me ekipin fillestar, nisi procedurën për regjistrim të këtij institucioni. Aktvendimi për regjistrimin e themelimit të Agjencisë u miratua më 13 mars 2019, datë kjo prej kur filloi ekzistenca e kësaj Agjencie. Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Tahir Hani, caktoi z. Pleurat Ajazin dhe Armend Fazliun, për ndihmës të drejtorit, i cili përzgjodhi tre këshilltarët e jashtëm të tij: prof. Izer Maksuti, prof. Nuri Bexheti dhe prof. Ajtene Qamili, si dhe bashkëpunëtorët tjerë: Emer Mustafa, Berna Mejdiu, Lirim Shabani dhe Artion Spahiu⁹. Sot Agjencia ka një ekip të konsoliduar, me mbi 50 të punësuar¹⁰, me këshilltarë shtetërorë të përkthimit, lekturës, dhe për bashkëpunim me qeverinë dhe publikun. Agjencia ka 4 sektorë: Sektori i mbështetjes së drejtorit, Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit, Sektori i përkthimit dhe i lekturës, Sektori i çështjeve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore. Në kuadër të këtyre sektorëve veprojnë 9 njësi: Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e RMV-së, Njësia e mbështetjes së drejtorit, Njësia e marrëdhënieve me publikun, Njësia e avancimit dhe e zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20 % e qytetarëve, Njësia e teknologjisë informative, Njësia e përkthimit, Njësia e lekturës, Njësia e çështjeve të përgjithshme dhe juridike dhe Njësia e menaxhmentit të burimeve njerëzore.¹¹

Ndër detyrat kryesore të Agjencisë, sipas nenit 19 të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve janë: mbështetja e institucioneve për zbatimin e ligjit, përkthimi dhe lekturimi i dokumentacionit, ligjeve, vendimeve të botuara në Gazetën zyrtare të RMV-së, informimi dhe këshillimi i Qeverisë së vendit për zbatimin e ligjit, sidomos përmes përgatitjes së analizave dhe studimeve dhe dhënies së mendimit profesional, si dhe promovimi dhe fushata për vetëdijesim qytetar të rëndësishëm të zbatimit të ligjit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës që e flasin së paku 20%.

Më tutje veprimtaria dhe qëllimet e Agjencisë përshkruhen si vijon:

“të ndërtojë një mjedis institucional që respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, mbron, promovon, ruan dhe zbaton të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes:

– bërjes së politikave gjuhësore dhe unifikimit të nocioneve administrative në bashkëpunim me ekspertë të fushës dhe institucione gjegjëse brenda dhe jashtë vendit,

⁹ <https://apj.gov.mk/history>

¹⁰ <https://apj.gov.mk/employees>

¹¹ <https://apj.gov.mk/hierarchy>

- trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve nëpër të gjitha institucionet e vendit,
- sigurimit dhe furnizimit të softuerit të përkthimit me fjalë dhe shprehje për institucionet qendrore,
- dhënies së këshillave ligjore qytetarëve për të drejtën e gjuhës amtare,
- bashkëpunimit të ngushtë me Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve dhe me të gjitha institucionet relevante të vendit,
- këshillimit të Qeverisë dhe institucioneve në lidhje me miratimin dhe zbatimin e masave që sigurojnë përdorimin dhe statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare,
- dhënies së rekomandimeve për institucionet qendrore dhe komunale për të inkurajuar, mbështetur dhe ofruar zgjidhje afatgjata, të qëndrueshme strukturore dhe një politikë stimulimi për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut¹².

Ashtu siç e parasheh Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, neni 20 (mbikëqyrjen e zbatimit të plotë të dispozitave të këtij ligji), është themeluar si institucioni i veçantë, Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve¹³, dhe ka ligj më vete për këtë Inspektorat.¹⁴

Bashkëveprimi i Agjencisë me Inspektoratin e Gjuhës është tepër i rëndësishëm. Për Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve, misionin dhe detyrat, shih më shumë në ueb faqen e tij.

Kujdes të veçantë Agjencia i kushton kultivimit të bashkëpunimit me institucionet e vendit, me Republikën e Kosovës, me Republikën e Shqipërisë, si dhe diasporën shqiptare. Te nënkapitulli 3.1.4 do flasim pak më gjerësisht për bashkëpunimin ndërinstitutional.

3.1 Ndhimesa e institucioneve dhe fushata e ndërgjegjësimit

Agjencia, duke njohur gjendjen reale dhe vështirësitë e trashëguara ndër vite e dekada, që nga themelimi, u përqendrua në punën e saj për:

1. Vetëdijesimin qytetar për rëndësinë dhe dobitë e shumëgjuhësisë sot, promovimin e një shoqërie demokratike që kultivon dhe garanton të drejta gjuhësore për secilin. Ky

¹² <https://apj.gov.mk/>

¹³ <https://iuj.gov.mk/>

¹⁴ <https://iuj.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/LIGJ-PER-INSPEKTORATIN-PER-PERDORIMIN-E-GJUHEVE-new.pdf>

ndërgjegjësim do të mundësonte kthesën: humbjen e frikës nga shqipja, heqjen dorë nga mohimi e pengimi i gjuhës shqipe, pra lejimin e përdorimit të barabartë të saj;

2. Ndërgjegjësimin qytetar dhe kombëtar të shqiptarëve për këmbënguljen në zbatimin e Ligjit të gjuhëve, përdorimin e vazhdueshëm dhe kurdohershëm të shqipes, krahas maqedonishtes, si dhe përkujdesja për përdorim të drejtë të gjuhës standarde shqipe.

Agjencia, krahas përmbushjes së detyrimeve të përditshme, bën fushatën e ndërgjegjësimit qytetar dhe kombëtar, për rëndësinë e dy- dhe shumëgjuhësisë, barazisë gjuhësore dhe rolin identitar të gjuhës kombëtare. Për atë Agjencia organizon në vazhdimësi aktivitete të ndryshme, sidomos gjatë këtyre ditëve: Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare (21 shkurt), Dita e Mësuesit (7 mars), Dita e Europës (9 maj), Dita Europiane e Gjuhëve (26 shtator), Dita Ndërkombëtare e Përkthimit (30.09), Dita e Flamurit (28 nëntor), për të ngritur vetëdijen.

3.1.1 Trajnimet

Bazuar në nevojën e përkthyesve të specializuar dhe domosdoshmërinë e zotërimit të mirë të gjuhës standarde shqipe, si në proces të përkthimit ashtu edhe në punën e përditshme të redaktimit dhe lekturimit të teksteve, Agjencia që dy vite me radhë ka organizuar trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve shqiptarë të institucioneve të vendit.

Trajnimi i përkthyesve dhe lektorëve të sektorit publik, është planifikuar nga Agjencia, që gjatë vitit 2020, por për shkak të pandemisë u shty. Trajnimi nisi të realizohet, në mjediset e Agjencisë, në fillim të prillit deri në fund të qershorit të vitit 2021 dhe po ashtu gjatë këtyre 3 muajve në vitin 2022. U trajnuan për çdo vit rreth 70 përkthyes dhe lektorë të institucioneve, organeve të administratës, të ministrive, ndërmarrjeve publike, gjykatave etj. Për trajnimin e tyre u angazhuan profesorët më eminentë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Këto trajnime janë mbështetur nga OSCE-ja dhe do të vazhdojnë edhe në vitet në vijim.

3.1.2 Tryeza shkencore, promovime botimesh me interes për ndërgjegjësimin gjuhësor

Si pjesë e strategjisë për veprim më efikas në procesin e ndërgjegjësimit qytetar, si dhe për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, Agjencia

organizoi takime pune, pritje në mjediset e saj, të personaliteteve shkencore e të kulturës, promovime botimesh dhe tryeza shkencore.

Veçojmë për të përmendur këtu tryezën shkencore me titull: “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, mbajtur më 30.09.2019, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, Shkup.

Në këtë tryezë shkencore morën pjesë, me kumtesa dhe dorëzuan ato për botim, këta studiues dhe profesorë universiteti: Ajtene Hajdari-Qamili “Zbatimi i shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut”, Izer Maksuti “Mbi domosdoshmërinë e përkthimit – me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit”, Qemal Murati “Gjedhe të zvetënimit gjuhësor të shqipes në përkthim”, Demush Bajrami “Mediat sociale si nxitje të reja në perceptimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor”, Asllan Hamiti “Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Zeqirija Ibrahimimi “Problemet e përdorimit zyrtar të shqipes standarde në Maqedoni”, Berton Sulejmani “Gjuha e mbishkrimeve private e publike sot” dhe Mustafa Ibrahimimi “Përkthimi i disa frazave midis gjuhës shqipe dhe maqedonase”. Të gjitha këta punime u botuan nga Agjencia si “Përmbledhje e kumtesave të tryezës shkencore SFIDAT E PËRKTHIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT. Mbajtur më 30.09.2019. Shkup 2020, 103 fq.

Të vetëdijshëm për rëndësinë e fushës së përkthimit dhe nevojën për përgatitje, trajnim dhe shkollim të përkthyesve profesionistë, Agjencia zhvilloi jo vetëm një program trajnimi vjetor, por përgatiti për botim, edhe një përmbledhje të disa shkrimeve në fushë të përkthimit, të prof. Xhevat Lloshit me titull: “**Shkrime rreth përkthimit**”. Shkup 2020, 159 fq. Botimi i kësaj përmbledhjeje, nga drejtori Sela, në parathënie, arsyetohet si në vijim: “*Meqë AZGJ-ja do t’i trajnojë përkthyesit dhe lektorët e të gjitha institucioneve të vendit, e shohim të arsyeshme që ky libër t’u ndihmojë të gjithë përkthyesve, jo vetëm atyre që punojnë në administratë, në punën e tyre të përditshme, sepse libri ndërthen në vete një spektër të gjerë temash që lidhen me përkthimin...*” (fq. 5).

Nga Agjencia, si në mjediset e saj në Shkup, po ashtu edhe në institucionet me të cilat ajo bashkëpunon, në Tiranë, Prishtinë, Shkodër, Prizren, Shkup etj, janë organizuar disa aktivitete dhe promovime librash, gjithëherë në shërbim të ngritjes së vetëdijes për rolin e gjuhës në shoqëri, dhe sidomos për statusin dhe rëndësinë e gjuhës standarde shqipe për shqiptarët në RMV. Për këtë ndihmesë të veçantë kanë dhënë personalitete të ndryshme të shkencës shqiptare në përgjithësi, dhe gjuhësisë sonë në veçanti, nga Shqipëria, Kosova dhe vendi ynë.

3.1.3 Botimet dhe konferencat

Agjencia, që nga fillimi i punës është kujdesur, të dokumentojë tërë veprimtarinë e saj në dobi të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Sidomos për të lehtësuar procesin e fushatës së ndërgjegjësimit qytetar, si dhe për të përshpejtuar përdorimin zyrtar të dygjuhësisë, ka përgatitur për botim materiale të ndryshme dhe ka organizuar një konferencë vjetore, me një temë bosht, si ndihmesë shtesë në këtë proces, të njohjes, ndërgjegjësimit dhe zbatimit të dygjuhësisë në vend.

3.1.3.1 Botimet

Krejt në fillim, që në verën e vitit 2019, Agjencia nisi me botimin e një Broshure informuese me **“Informacione mbi të drejtat gjuhësore të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”**. Kjo broshurë me mbi 60 faqe, ndër të tjera përmban: të dhëna për krijimin e Agjencisë, për misionin, rolin dhe fushëveprimin e saj, ofron njohuri për të drejtat themelore gjuhësore, këshilla për zbatimin në praktikë të dygjuhësisë, mundësi për ankesa në rast diskriminimi në baza gjuhësore. Në pjesën tjetër këtu janë botuar të plotë “Ligji i Përdorimit të Gjuhëve” dhe “Ligji i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve”. Kjo broshurë, përgatitur dhe shtypur në 3 gjuhë: shqip, maqedonisht dhe anglisht, shpërndahet falas, dhe mund të shkarkohet në ueb faqen e Agjencisë.¹⁵

Punonjësit e Agjencisë, gjatë punës së përditshme, të takimeve të punës, veprimtarisë për informim dhe ndërgjegjësim qytetar, bënin shpërndarjen e kësaj broshure.

Si material i radhës, gjithnjë në funksion të informimit më të plotë, u përgatit dhe botua një **“Udhëzues i zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve”** në vjeshtën e vitit 2019. Ndër qëllimet kryesore të këtij udhëzuesi *“është t’i ndihmojë nëpunësit të zbatojnë Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve në mënyrë përkatëse, si dhe t’ua sqarojë qytetarëve të drejtat gjuhësore, çfarë mund të presin ata nga zbatimi i këtij Ligji dhe si mund të veprojnë atëherë kur konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat gjuhësore”*.¹⁶ Ky udhëzues, i formatit A4, me 50 faqe, konceptuar në 4 pjesë, përmban: 1. Të dhëna mbi kornizën ligjore të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Nisur me nenet për përdorimin e gjuhës shqipe në Kuvendin dhe Qeverinë e RMV-së, si dhe rregullimin ligjor për në institucionet tjera qendrore. Veçohen këtu nenet që rregullojnë përdorimin e dygjuhësisë, pra edhe të gjuhës shqipe, krahas maqedonishtes, te emrat e institucioneve, vultat dhe zyrat rajonale, në procedura gjyqësore, te

¹⁵ <https://apj.gov.mk/document/brochure?category=Brochure>

¹⁶ Shih aty, f. 7; <https://apj.gov.mk/document/guidebook?category=Guidebook>

dokumentet personale, gjatë procesit zgjedhor, për emërtimin e rugëve, shesheve dhe objekteve tjera, si dhe në vendkalimet kufitare etj.

Në pjesën e dytë titulluar “Si të arrihet statusi i barabartë i gjuhëve zyrtare”, nisur nga fati se “*të drejtat gjuhësore janë pjesë integrale e së drejtës themelore të njeriut mbi lirinë e shprehjes*” (fq. 25), jepen sqarime për lehtësimin e procesit të realizimit të këtyre të drejtave, në institucionet qendrore, lokale, si dhe për obligimet e këtyre institucione për zbatimin e këtij ligji. Në pjesën e tretë të Udhëzuesit me titull: “Zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve gjatë komunikimit me qytetarët”, në mesin e shumë të dhënave, jepen udhëzime për mënyra të lehtësimit të komunikimit të institucioneve me qytetarët, të komunikimit ndërinstytucional, të hartimit të shkresave në një gjuhë që kuptohet lehtë, për detyrimin ligjor të institucioneve për raportim vjetor për punën e tyre, në të dyja gjuhët zyrtare etj. Pjesa e katër përmban dy nënkapituj të shkurtër me të dhëna mbi “Rolin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës” dhe “Si të ankoheni për shkeljen e të drejtës gjuhësore”, duke përmendur detyrat e rolin e Agjencisë dhe duke sqaruar mënyra të parashtrimit të ankesës, e cila “*mund të bëhet në cilëndo nga gjuhët zyrtare*”, ku jepen sqarime për plotësimin e formularit përkatës. Udhëzuesi përmbyllet me një “Fjalorth të termave të administratës” në dy gjuhë, maqedonisht dhe shqip, fq. 34-50.

Në fillim të vitit 2020 u botua një “**DORACAK i nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve**”. Shkup: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës 2020.¹⁷

Doracaku me mbi 80 fq., me format A4, konceptuar në dy pjesë kryesore, është përgatitur nga disa bashkëpunëtorë të Agjencisë, siç shprehet drejtori Sela “*për nevojat e nëpunësve administrativë lidhur me zbatimin praktik të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve*”.

Në pjesën e parë të doracakat gjejmë këto shkrime, të pesë autorëve:

Jusuf Zejneli “Hartimi i Legjislacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Zeqirja Ibrahim “Planifikimi gjuhësor në Maqedoninë e Veriut”, Izer Maksuti “Politikat gjuhësore europiane”, Xhevat Lloshi “Leksiku shoqëror e politik” dhe Xhemi Hajredini “Komunikimi ndërinstytucional dhe me qytetarët”.

Në pjesën e dytë të këtij doracaku, përgatitur nga Ajtene Hajdari-Qamili, Asllan Hamiti, Bashkim Selmani dhe Ismail Hamiti, siç sqaron në parathënie prof. Sela “*janë dhënë të gjitha format e nevojshme që u nevojiten atyre në rrafshin e komunikimit administrativ: si shkruhet një lutje, një kërkesë, një njoftim, një procesverbal, një ftesë, një kontratë, një ankesë etj. Krahas këtyre, në mënyrë të veçantë janë dhënë sqarime edhe për përdorimin zyrtar të gjuhëve në gjykata, në udhëheqje, menaxhim, financa etj.*” (f. 7).

¹⁷ <https://apj.gov.mk/document/handbook?category=Handbook>

Në këtë pjesë të prezantimit të botimeve të Agjencisë, do përmendim edhe vetëm këta dy botime:

1. Libri me titull: “GJUHA SHQIPE PARA DHE PAS MIRATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE TË VITIT 2019” 184 fq.

Ndër qëllimet kryesore të librit, sipas autorëve, mbetet “*sqarimi i pozicionit, i funksionit dhe i kuptimit të gjuhës shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019*”. Kemi të bëjmë me një studim që përfshin, një kornizë kohore të rregullimit ligjor, prej 75 vjetësh, nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri më sot.¹⁸

2. Botimi i dy autorëve: Ylber Sela, Llazo Matovski: *Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Shkup 2022.¹⁹

Sipas autorëve botimi “*përqendrohet në aspektet materiale dhe procedurale-juridike të përdorimit të gjuhëve në sistemin juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me referencë të veçantë në rregullimin e tyre juridik dhe përdorimin në organet gjyqësore, duke iu referuar akteve më të rëndësishme ndërkombëtare që 15 kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe të drejtën e mosdiskriminimit gjuhësor*” (f. 14).

3.1.3.2 Konferencat

Që në fillim të punës së Agjencisë, duheshin vendosur prioritetet në punë për mandatin e marrë, ku sidomos në disa fusha nevojiteshin njohuri shtesë. Prej shumicës së vështirësive dhe detyrave që dolën, u veçua si më e arsyeshme dhe më e domosdoshme, të mësohet më shumë për dukuritë dhe fushën e shumëgjuhësisë në shoqëritë e sotme dhe për rëndësinë e njohjes së risive në shkencën e terminologjisë, gjuhët profesionale dhe në procesin e përkthimit.

Kjo mbase ishte ndër arsyt bazë përse Agjencia u përcaktua për organizimin e një konference vjetore, ku do të trajtoheshin tema boshte, nga studiues dhe hulumtues të njohur, kombëtarë e ndërkombëtarë, për të mësuar më shumë dhe për të hulumtuar njohuri të reja për ne. Për atë, jo pa arsye, si temë e parë për t’u trajtuar u përzgjedh shumëgjuhësia, ndërlidhur me zbatimin

¹⁸ Shih recensionin e Izer Maksutit për këtë botim: Ylber Sela, Jusuf Zejneli, Jeton Shasivari, Valbona Hajretin, Argëtim Salii, Llazo Matovski (2021): “*Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019*”. Botuar në GJUHA SHQIPE, Viti XXXIX, 3/2021, Prishtinë Instituti Albanologjik, dhe në KOHA, 24.11.2021, 18. Shkup. <https://www.koha.mk/gjuha-shqipe-para-dhe-pas-miratimit-te-ligjit-te-perdorimit-te-gjuheve-te-vitit-2019/> (24.11.2021)

¹⁹ Ylber Sela, Llazo Matovski: *Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Shkup: Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV-së, 2022, 241 fq.

praktik të politikave gjuhësore, për të lehtësuar procesin e implementimit të ligjit të gjuhëve në vend.

Për atë, me rastin e Ditës Ndërkombëtare Amtare më 21 dhe 22 shkurt 2020, në Shkup, zhvilloi punimet KONFERENCA shkencore ndërkombëtare, me temë boshte. “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV”. Këtu morën pjesë emra të njohur të gjuhësisë shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, diaspora, si dhe dy hulumtuese nga Qendra Hulumtuese Eurac, në Bolzano/Bozen, Tiroli i Jugut, në Itali.

Pas një viti, punimet e kësaj konference, me përkujdesjen e një Këshilli shkencor mbarëkombëtar e ndërkombëtar, u botuan nga Agjencia. Botimi, titulluar sipas temës bosht të konferencës, në ballinë përmban këto të dhëna: “PUNIMET E KONFERENCËS, KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE PËR DITËN NDËRKOMBËTARE TË GJUHËS AMTARE, mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup, “SHUMËGJUHËSIA DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE NË RMV”. Shkup 2021, 258 fq.

Po japim përmbajtjen e punimeve të kësaj konference, sipas alfabetit: Ajten Hajdari – Qamili “Nevoja e njësitit të terminologjisë administrative dhe përfshirja e tyre në fjalorët terminologjikë”, Asllan Hamiti “Redaktimi profesional dhe gjuhësor i përkthimeve”, Bashkim Selmani “Juridiksioni dhe përdorimi institucional i gjuhës shqipe në RMV, prioritetet dhe sfidat”, Berton Sulejmani “Toponimia shqiptare në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut”, Besim Kabashi “Ndërtimi i korpuseve paralele për nxjerrjen e terminologjisë për gjuhën shqipe”, Demush Bajrami / Emin Azemi “Maqedonia e Veriut dhe sfidat e shtrirjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe”, Dimitar Pandev “Teoria e shumëgjuhësisë në gjuhësinë maqedonase (referim i posaçëm për studimet gjuhësore të Olivera Jashar-Nastevës)”, Emil Lafe “Sfida të shqipes letrare në RMV në rrethanat e dygjuhësisë zyrtare”, Haki Ymeri “Shqipja e Maqedonisë së Veriut – Gjuhë e njëzet përqindëshit”, Ismail Hamiti “Përkthimi i lirë dhe përkthimi i fjalëpërfjalëshëm”, Ismet Osmani “Probleme kuptimore në terminologjinë e Administratës Publike”, Izer Maksuti “Politika gjuhësore në Tirolin e Jugut dhe në Belgjikë, me disa të dhëna mbi statusin e shqipes në RMV”, Jusuf Zejneli “Sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Klara Kranebitter “Puna terminologjike në Tirolin e Jugut, Itali, dhe Sistemi i informacionit për terminologjinë juridike ‘bistro’”, Mimoza Kore “Ligji i Përdorimit të Gjuhëve në RMV dhe sfidat e statusit të shqipes në këtë kontekst”, Qemal Murati “Çështja e gjuhës amtare – boshti rreth së cilit sillen dhe të gjitha të drejtat e tjera”, Rami Memushaj “Standardet e dyfishta të dygjuhësisë për Ballkanin”, Veronika Kareva “Qasja ndaj mësimit të gjuhës si një mjet motivues për popullarizimin e gjuhës shqipe mes nxënësve të rinj maqedonas dhe prindërve të tyre” dhe Zeqirija Ibrahimiti “Politikat gjuhësore europiane në përjasje me politikën

gjuhësore në RMV”. Ky botim u promovua në Konferencën e dytë Shkencore Ndërkombëtare, me temë boshte: “Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale”, mbajtur më 29-30 shtator 2021, në Shkup. Në këtë konferencë pati po ashtu pjesëmarrje nga studiues dhe profesorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Bullgari dhe Italia.

Punimet e kësaj konference të dytë u botuan më vete, me titull:

KONFERENCA shkencore ndërkombëtare. “Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale”. Shkup 2022, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, 261 fq.

Ja përmbajtja e kësaj përmbledhjeje punimesh: Albina Pajo “Një vështrim përmbajtësor mbi marrëdhëniet e terminologjisë me gjuhësinë, gjuhësinë e aplikuar dhe me disiplina të ndryshme gjuhësore”, Anton Pançev “Njësimi dhe përkthimi i disa termave në shqip sipas dispozitave të Traktateve me Greqinë dhe Bullgarinë”, Elena Chiocchetti “Sfidat terminologjike në gjuhën gjermane si gjuhë e pakicës në Tirolin e Jugut: Shembulli i shëndetit dhe i sigurisë në punë”, Evalda Paci “Çështje të terminologjisë shkencore në disa disiplina themelore të albanologjisë (vështrim diakronik dhe analitik)”, Isa Mulaj, Ruzhdi Matoshi, Florin Aliu “Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet detyrat”, Izer Maksuti “Roli i terminologjisë profesionale në përkthimin e teksteve të specializuara”, Juljana Kume, Sabri Hoxha “Veçori të terminologjisë së mjekësisë ligjore”, Magdalena Anxhelika Shitov “Terminologjia dhe roli i saj në interpretim”, Olger Brame “Çështje të shqipërimin të terminologjisë në shënimet gjuhësore të Aleksandër Xhuvanit”, Teuta Sula “Terminologjia në klasifikimin lëndor të bibliotekës”, Teuta Toska “Fjalorët terminologjikë: pasuri për t’u vlerësuar apo traditë për t’u mënjeluar?”, Xhafer Beqiraj “Disa probleme të terminologjisë në gramatikën e shqipes”, dhe Zeqirija Ibrahim “Terminologjia profesionale ndërmjet njësimin dhe përkthimit”. Kjo përmbledhje punimesh përmban edhe një shtojcë me këto kumtesa dhe recensione, që u lexuan gjatë promovimit të përmbledhjes punimeve të Konferencës së parë: Ali Pajaziti “Odiseja e shqipes në RMV: 1946-2021“, Liljana Pandeva “Përkritazi me përmbledhjen“, Mustafa Ibrahim “Botim me vlerë për dygjuhësinë në shtetet multikulturore”, Valter Memisha Fjalim me rastin e promovimit të studimit “Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019”.

Për herë të tretë radhazi, u organizua KONFERENCA shkencore ndërkombëtare, kësaj radhe me temë: “Çështje të standardizimit të toponimisë në RMV”, më 29-30 shtator 2022, në Shkup. Në fillim të punimeve të kësaj konference u bë promovimi i botimit të përmbledhjes së punimeve të Konferencës së dytë.

Përmbledhja e punimeve të konference së tretë, do të botohet dhe promovohet në konferencën e katërt me radhë, që planifikohet të mbahet më 29-30 shtator 2023, në Shkup.

Botimet e konferencave dhe shumicën e botimeve të Agjencisë i gjeni në ueb faqen e saj, ku mund të shkarkohen falas.²⁰

3.1.4 Vizita pune dhe bashkëpunimi ndërinstitucional brenda e jashtë vendit

Agjencia, e vetëdijshme për përgjegjësinë që ka, për faktin se nis nga e para, dhe i duhet përvoja dhe ndihmesa e institucioneve dhe vendeve tjera, që në fillim kontaktoi dhe bëri vizita pune me institucione të ndryshme shkencore dhe arsimore të vendit, shteteve tona fqinje dhe në disa vende perëndimore.

Agjencisë përkrahje dhe ndihmesë të veçantë, në këtë proces të ngritjes dhe funksionalizimit të saj, i kanë dhënë personalitete dhe emra të mirënjohur të gjuhësisë dhe shkencës shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe diaspora jonë.

Do përmendim këtu disa prej tyre: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Korçës, Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Europës Juglindore Tetovë/Shkup, Universiteti “Nënë Tereza” Shkup.

Me të gjithë këto institucione të njohura arsimore dhe shkencore, Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe është përkujdesur që të realizohet ajo që është paraparë, përmes pjesëmarrjes në aktivitete, konferenca, promovime, trajnime, botime, dhe vazhdon të përkujdeset për kultivimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Vizitë pune, drejtori i Agjencisë dhe disa bashkëpunëtorë të tij, patën më 12 dhe 13 dhjetor 2019, në Qendrën Hulumtuese EURAC (Europäische Akademie Bozen-EURAC)²¹, në kryeqytetin Bolzano/Bozen, të Tirolit të Jugut, në Itali. Ata u pritën nga drejtoresha e Institutit të Gjuhësisë së Zbatuar, prof. Andrea Abel, me hulumtues tjerë të këtij instituti: Klara Krenebitter, Caroline Zwilling, si dhe me Marc Emanuel Röggl, drejtues i “Center for Autonomy Experience”²².

Bashkëpunimi me këtë Qendër vazhdon me sukses, drejtoresha prof. A. Abel dhe hulumtuesja Klara Krenebitter morën pjesë në Konferencën e parë, që u organizua nga Agjencia më 21 dhe 22 shkurt 2020. Po ashtu hulumtuesja

²⁰ <https://apj.gov.mk/document/variouspublications?category=Various%20Publications>

²¹ <https://www.bolzano.net/de/eurac.html>, <https://www.eurac.edu/de/institutes-centers/institut-fuer-angewandte-sprachforschung>

²² <https://www.eurac.edu/de/institutes-centers/center-for-autonomy-experience>

tjetër e kësaj, Elena Chiochetti, mori pjesë në Konferencën e dytë, më 29 dhe 30 shtator 2021, në Shkup. Ata kanë mbajtur kumtesa dhe kanë dërguar punimet, që janë botuar si përmbledhje e kumtesave për çdo konferencë vjetore më vete.

Më 25-16 maj 2022, drejtori Agjencisë, prof. dr. Ylber Sela, shoqëruar nga prof. asoc. dr. Izer Maksuti, bëri një Udhëtim studimor në Grac, Austri, ku u zhvillua një takim pune me drejtuesit e “Qendrës Europiane për Gjuhët Moderne”²³ me të cilët folën *“për modelet e suksesshme të shumëgjuhësisë në Europë, mundësitë e mbështetjes së përdorimit të dygjuhësisë dhe shumëgjuhësisë, mënyrat më efikase për vetëdijesimin qytetar, si dhe për përparësitë që ofron shumëgjuhësia në përgjithësi”*.²⁴

Takimi i dytë i punës u zhvillua me drejtoreshën e “Qendrës për Gjuhë, Plurilingualizëm dhe Didaktikë” (Zentrum für Sprache, Plurilingualismus und Fachdidaktik), dr. Daniela Unger-Ullmann, në Universitetin e Gracit²⁵, këtu ndër të tjera u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit ndërinstytucional, veçmas në fushë të zhvillimit të politikave gjuhësore, dokumentimit të gjuhës, si dhe risitë në mësimin dhe mësimdhënien e gjuhëve.

Vizita tjera pune, të kësaj natyre, janë planifikuar të bëhen edhe në Strasburg, Francë; në Bruksel, Belgjikë; në Helsinki, Finlandë; në Bernë, Fribourg/Freiburg, Zvicër etj., por për shkak të pandemisë nuk u realizuan. Do duhet të vazhdohet me vizita të tilla pune dhe qëndrime studimore në këto vende të Europës, për të mësuar më shumë, nga përvoja e tyre me shumëgjuhësinë, politikat gjuhësore të zbatimit praktik të dy e më shumë gjuhëve, në përditshmëri, në administratë, në gjyqësor, në shëndetësi, në shkolla etj.

3.1.5 Anketimet, intervistat, raportet vjetore

Agjencia, që nga themelimi i saj, si pjesë të strategjisë së komunikimit më efikas me qytetarët, ka organizuar konferenca për shtyp, ka dhënë intervista, deklarata, njoftime për mediat, ka njoftuar rregullisht për aktivitete e ndodhi të organizuara nga AZGJ-ja.²⁶ Ajo ka dokumentuar vazhdimisht punën e saj, për këtë ka përgatitur dhe botuar raporte vjetore. RAPORTI VJETOR i punës së Agjencisë për vitin 2020, është publikuar në fillim të vitit 2021, ka 138 fq., A4, ndërsa RAPORTI VJETOR për vitin 2021, doli në shkurt 2022, me 168 fq., A4. Po ashtu në muajt e parë të vitit 2023 do të botohet raporti i radhës

²³ <https://www.ecml.at/>, The European Centre for Modern Languages (ECML)

²⁴ <https://apj.gov.mk/posts/vizite-e-suksesshme-e-drejtorit-sela-ne-grac-te-austrise>

²⁵ <https://treffpunktsprachen.uni-graz.at/de/treffpunkt-sprachen/team/lehre-organisation/leitung/>

²⁶ <https://apj.gov.mk/page/speeches?category=Speeches%5CInterviews>

për vitin 2022, por në përgatitje është edhe një raport i përgjithshëm për të gjithë punën gjatë mandatit të parë 4-vjeçar, të kësaj Agjencie.

3.2 Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në RMV

Gjatë përpjekjeve për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit 2001, pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve 2008, Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve 2019, dhe në këta 4 vitet e fundit, ka disa përmirësime, krahasuar me gjendjen e mëparshme.

Agjencia është përpjekur të ndihmojë procesin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, si dhe të përshejtojë përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në RMV, brenda të mundësive dhe detyrave të saj, aq sa e lejon ligji.

Neni 1, paragrafi 1-4, i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, japin bazën e mundësisë së përdorimit të gjuhëve zyrtare, përkatësisht gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, kusht ky i cili plotësohet vetëm nga shqiptarët, me këtë gjuha shqipe, bëhet gjuhë e dytë zyrtare në vend, krahas maqedonishtes. Po japim këtu vetëm tekstin e këtij neni, për të lehtësuar njohjen me problematikën tematike dhe me dilemat e sfidat që dalin gjatë procesit të zbatimit.

Neni 1

- (1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.
- (2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.
- (3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.
- (4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Është debatuar, folur e shkruar, sidomos më shumë, në këta 5 vitet e fundit, për sfidat e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në RMV. Në një studim

më të mëhershëm tonin, veçojmë disa sfida të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në RMV: “Vonesa dhe skepticizmi për (mos)zbatimin në praktikë të ligjit për gjuhët; lëshimet e këtij ligji; përkufizimi jo i qartë se bëhet fjalë për gjuhën shqipe, por përmes formulimit si “gjuhë të cilën e flasin mbi 20 për qind nga numri i përgjithshëm i popullatës në Maqedoni”; e kaluara dhe ngarkesa historike; mungesa e tolerancës ndëretnike; protestat dhe kundërshtimet e shumta të palës maqedonase; vetëdija e ulët e palës shqiptare për peshën kombëtare e identitare që ka zbatimi zyrtar i gjuhës amtare; mangësi e mungesë e kompetencës së duhur për përdorimin e drejtë të gjuhës standarde shqipe etj.” (Maksuti 2021, 39-40).²⁷

Po te ky studim gjejmë sqarime tjera për arsyet e vonesës dhe vështirësi të zbatimit, si joserioziteti dhe neglizhenca, mungesa e vullnetit politik, mosnjohja e duhur e problemeve dhe mungesa e përvojës, ku shtohen edhe këto dy dukuri:

- 1) Është rregulluar me ligj, por nuk zbatohet (shpesh nuk e zbatojnë edhe ata që janë përgjegjës). Me këtë nuk respektohen edhe afatet e parapara sipas nenit 23 të ligjit;
- 2) Nis të zbatohet, por me lëshime dhe gabime të pa tolerueshëm (sidomos te mbishkrimet, tabelat), apo fare të papërdorshëm, jofunksional e të padobishëm (rasti i teksteve të përkthyerat)” (Maksuti 2021, 49).

Mbetet edhe shumë për të bërë, që të arrihet zbatimi i plotë i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019, sidomos pritet të shtohet mbështetja nga Qeveria, por edhe të zbatohet nga vetë ajo, siç e përdor që më parë edhe parlamenti i vendit. Nëse do të zbatohet ky ligj, me gjithë kufizimet e lëshimet që ka, brenda një kohe të shkurtër, do të krijoheshin mundësitë që të punohej në përmirësimin e kësaj kornize ligjore, meqë me të drejtë, siç përmendet vazhdimisht, dhe nga shumë palë ka vërejtje të ndryshme, pasi edhe ky ligj nuk bazohet në realitetin shumetnik dhe shumëgjuhësor të vendit.

4. Përfundimi

Në këtë punim u përpoqëm të japim një pasqyrë të historikut të Agjencisë që nga themelimi në mars 2019, të veprimtarisë së saj gjatë këtyre 4 viteve, deri në mars të vitit 2023: takimeve të punës, bashkëpunimit ndërinstytucional, trajnimeve, konferencave, botimeve, fushatës së ndërgjegjësimit e gjithë

²⁷ Për më shumë shih: Maksuti, Izer: “Disa sfida të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. GJUHA SHQIPE, Viti XXXIX, 2/2021, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021, fq. 39-67; dhe në: JUVENILJA, revistë mujore për kulturë dhe dije, Shkup, nr. 3-4, Shtator/Tetor, 2022, fq. 55-82.

aktivitetit të përditshëm të saj. Ofruam disa të dhëna për kornizën ligjore të rregullimit ligjor të përdorimit të gjuhëve në RMV. U përmendën veçori të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, risitë që sjell ai për mundësitë e përdorimit të dygjuhësisë në vend, si dhe vërejtjet ndaj ligjit, ngecjet, pengesat dhe vështirësitë që dalin gjatë përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe.

Duke përmbledhur këtë punim, me qëllimin e përshkrimit më të qartë të sfidave dhe ngecjeve në këtë proces të zbatimit të ligjit të gjuhëve, do të përmendim rishtas këto arsye:

“1. Mbi 4 dekada gjatë kohës së komunizmit dhe 3 dekada tranzicion e demokraci, ka mbizotëruar përdorimi i gjuhës maqedonase si gjuhë e vetme zyrtare e shtetit. Nga kjo duket se një pjesë e nëpunësve shqiptarë janë mësuar me përdorimin e kësaj gjuhe;

2. Disa nëpunës shqiptarë (madje ndër ta edhe drejtues të institucioneve) shpërfillin këtë detyrim ligjor, nga droja e paragjykitimit dhe stigmatizimit nga pala maqedonase, apo edhe nga frika e diferencimit nga eprorët maqedonas;

3. Duket se ende mungon vetëdija ndër shqiptarët e këtushëm, te një pjesë e mirë e nëpunësve shqiptarë, për peshën që ka përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe. Përveç kësaj atyre u mungon edhe kompetenca e duhur për përdorimin e drejtë të gjuhës standarde shqipe.” (Maksuti 2021, 57).

Urojmë që kjo paraqitje e Agjencisë dhe e specifikave të përdorimit zyrtar të shqipes, të jetë një nxitje edhe për shkrime tjera mbi çështjen e statusit të gjuhës shqipe në RMV, si dhe për vetë veprimtarinë e Agjencisë.

Shpresojmë që ky shkrim të jetë një ndihmesë edhe për njohjen e ndërsjellë të shqiptarëve, për të mësuar më shumë për problemet e njëri-tjetrit, pasi vërejmë që për këtë kanë gjithnjë e më shumë nevojë, meqë jetojnë nëpër shtete të ndryshme.

Bibliografia (përzgjedhje)

Ibrahimi, Zeqirija (2018). “Statusi i gjuhës shqipe në Maqedoni”. Në: *Gjuha shqipe në Maqedoni – histori dhe perspektiva* (Panel shkencor mbajtur më 18.06.2018, Shkup). Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, SCUPI, vëllimi 22, f. 139-163.

Konferenca 2020 = KONFERENCA shkencore ndërkombëtare për ditën ndërkombëtare të gjuhës amtare. *Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*. Shkup, 2021. Botues: AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS E RMV-së.

- Lantschner, Emma (2021). “North Macedonia’s Language Law of 2018: To Good to be True?” Në: *European Yearbook of Minority Issues*. 18. 2021, f. 184-202.
- Maksuti, Izer (2021). “Disa sfida të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut”. *GJUHA SHQIPE*, Viti XXXIX, 2/2021, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021, f. 39-67 & *JUVENILJA*, revistë mujore për kulturë dhe dije, Shkup, nr. 3-4, Shtator/Tetor, 2022, f. 55-82.
- Memushaj, Rami (2021). “Standardet e dyfishta të dygjuhësisë për Ballkanin”. Në: *Konferenca 2020*, f. 212-225.
- Reka, Blerim ed. (2011). *Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. A funksionon Maqedonia si shtet multi-etnik? Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.* https://www.seeu.edu.mk/files/research/projects/OFA_SHQI_P_FINAL.pdf (21.12.2022)
- Rrokaj, Shezai (2020). “LIGJI PËR GJUHËT NË MAQEDONINË E VERIUT DHE GJUHA SHQIPE”. Në: *Albanologjia* (Tetovë), 2020, 7, f. 47-55; <https://eprints.unite.edu.mk/526/1/6.pdf> (22.11.2022)
- Rustemi, Ferit (2011). “Statusi shoqëror-politik i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit: Model i planifikimit të pabarazisë”. Në: Reka, Blerim (ed.), f. 204-210.
- Sinani, Arsim (2015). *(Mos)Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë*. Tiranë: UET Press, Universiteti Europian i Tiranës.
- Sela, Ylber et al. (2021). *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019*. Grup autorësh: Shkup: AZGJ.

SUMMARY

Agency of Language Implementation – Its Activities 2019 – 2023

In the Republic of North Macedonia, as a multi-ethnic country with numerous spoken languages and in light of the Ohrid Agreement of August 2001, some constitutional changes and new regulations on the status of languages have been achieved so far.

Following the approval of the Law on The Use of Languages in the Republic of North Macedonia from January 2019 and since the foundation of

the Language Implementation Agency in March 2019, improvements on the status of the Albanian language have been made, but difficulties in implementing the law have occurred and the use of Albanian as an official language is still disrupted by many challenges.

This paper will focus on giving an introduction of the Language Implementation Agency, starting off from its founding in 2019. We intent to offer a reflection on its history and give insight into its mission in the process of implementing Albanian as the second official language in the Republic of North Macedonia. Some of the main challenges that the implementation of the law has brought to light will be mentioned and obstacles that the use of Albanian as an official language faces will be further examined, in particular compared to the Macedonian language.

This paper intent on giving a summarized overview on the achievements of the Language Implementation Agency starting from its foundation and on shining through the process of the implementation of the Law on the Use of Languages.

